



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 318 Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M

Nr. 34, datë 01.04.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Durrës”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 95, datë 14.09.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës”, në lidhje me procesin e inspektimit të administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Këshilli i Qarkut Durrës,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 41, datë 24.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 95, datë 14.09.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Durrës, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Të kryhet procesi i deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit ***** dhe ***** dhe më tej të nxirren aktet përkatëse për sistemin pas ristrukturimit.
3. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 115 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të bëjë revokimin e akteve të emërimit për punonjësit si më poshtë:
 - a. Të revokohet akti i emërimit nr.1738 prot., datë 03.12.2014, për punonjësen *****, në pozicionin “*Specialist i koordinimit dhe hartimit të projekteve në Sektorin e Hartimit, Koordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale*”, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - b. Të revokohet akti i emërimit nr.1743 prot., datë 05.12.2014, për punonjësen *****, në pozicionin “*Specialist i koordinimit dhe hartimit të projekteve në Sektorin e Hartimit, Koordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale*”, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - c. Të revokohet akti i emërimit nr.1740, datë 03.12.2014, për punonjësen *****, në pozicionin “*Specialiste e Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit*”, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - d. Të revokohet akti i emërimit nr.1703, datë 27.11.2014, për punonjësen *****, në pozicionin “*Specialist Kulture në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit*”, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “*Pranimi në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - e. Njësia përgjegjëse të bëjë regjistrimin e këtyre nëpunësve në listën e kandidatëve fitues, e cila është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare, duke përfituar nga mundësia që jep ligji për emërim të drejtpërdrejtë prej saj, sapo të konstatohet një pozicion i lirë, ku kandidati plotëson kërkesat e vecanta të atij pozicioni.
 - f. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i*

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Me shkresën nr.1874 Prot., dt. 12.10.2015, administruar nga inspektorët e KMSHC-së gjatë procesit të mbikëqyrjes, Këshilli i Qarkut Durrës ka vënë në dijeni Komisionerin, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 95, dt.14.09.2015 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës*”. Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhej dhe dokumentacioni shkresor që provon zbatimin e vendimit.

Në përfundim të verifikimit, u konstatua se njësia përgjegjëse ka zbatuar rekomandimet e dhëna dhe ka nxjerrë aktet administrative. Konkretisht rezultojnë se:

- ✓ Në zbatim të pikës të pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.95, datë 14.09.2015, të Komisionerit, me shkresën nr.1872, datë 12.10.2015 ka dalë akti i deklaramentit të statusit të punësimit për punonjësen ***** në pozicionin “*Specialiste e Menaxhimit dhe Zhvillimit të Mjedisit, në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës*” dhe me shkresën nr.1873, datë 12.10.2015 ka dalë akti i deklaramentit të statusit të punësimit për punonjësen ***** në pozicionin “*Specialiste e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse*”, sipas rekomandimeve të Komisionerit.
- ✓ Në zbatim të pikës 3, njësia përgjegjëse ka bërë revokimin e akteve të emërimit, të kërkuara si më poshtë:
 1. Për nëpunësen ***** me Urdhrin nr.85, dt.05.10.2015 “*Për revokimin e aktit të emërimit nr.1738, dt.3.12.2014*”,
 2. Për nëpunësen ***** me Urdhrin nr.87, dt.05.10.2015 “*Për revokimin e aktit të emërimit nr.1743, dt.5.12.2014*”,
 3. Për nëpunësen ***** me Urdhrin nr.86, dt.05.10.2015 “*Për revokimin e aktit të emërimit nr.1740, dt .3.12.2014*”,
 4. Për nëpunësen ***** me Urdhrin nr.88, dt.05.10.2015 “*Për revokimin e aktit të emërimit nr.1703, dt.27.11.2014*”.

Sa më sipër, u konstatua se reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes ka qenë i menjëhershëm dhe në përfundim arrijnë në konkluzionin se Vendimi nr. 95, datë 14.09.2015, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Durrës**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Këshilli i Qarkut Durrës.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 95, datë 14.09.2015 ,*“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës”*.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Durrës dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA